

Kina në fokus

Seria “Kina në fokus”

Bordi redaktues

Kryetar

Du Zhanyuan

Nënkryetar:

Lu Cairong

Anëtarët (sipas rendit alfabetik):

Chen Jin, Chi Fulin, Han Zhen, Hu Fuguo, Hu Kaimin,
Huang Changqi, Jin Nuo, Jing Ruibin, Li Junru, Lin Feng,
Wang Yi, Wang Yiwei, Xiao Shiling, Xie Chuntao, Xu Bin,
Xu Bu, Xu Rong, Yu Xiang, Yu Ying, Zhang Haiou

Redaksia

Drejtor:

Xu Bu

Zëvendësdrejtor:

Hu Kaimin

Anëtarë:

Yu Ying, Wen Fang

Nga Pasurimi te Fuqizimi

**Një histori e Reformës
dhe e Hapjes së Kinës**

Chi Fulin, Zhang Juan, Chen Wei



PUBLISHING HOUSE "FAN NOLI"

**NGA PASURIMI
TE FUQIZIMI**
Një histori e Reformës dhe e Hapjes së Kinës

**FROM GETTING RICH
TO GETTING STRONG**
A History of China's Reform and Opening Up



PUBLISHING HOUSE "FAN NOLI"



外文出版社
FOREIGN LANGUAGES PRESS

Copyright © 2018 by Foreign Languages Press Co., Ltd.
Albanian Translation Copyright © 2020 by Foreign Languages Press Co., Ltd.
& Fan Noli Publishing House

All rights reserved.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të kopjohet apo të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, skanim, ose ndryshe, përveçse kur lejohet shprehimisht nga ligji.

Copyright manager and Editor: Dou Qiang

ISBN 978-9928-291-94-3

Shënimet e botuesit

Presidenti Xi Jinping ka thënë: “Sot bota është më e lidhur se kurrë më parë. Edhe Kina është e hapur për botën më shumë se kurrë më parë. Marrëdhëniet midis Kinës dhe botës po pësojnë ndryshime historike. Kina duhet të mësojë më shumë rreth botës dhe bota duhet të mësojë më shumë rreth Kinës.”

Kina po i afrohet gjithnjë e më shumë qendrës së arenës ndërkombëtare. Në një botë që karakterizohet nga transformimi dhe pasiguria, në të cilën modeli i fuqive globale po ndryshon me shpejtësi, po rritet së tepërmi vëmendja ndaj Kinës. Njerëzit janë të interesuar për rrugën që ka përshkuar vendi dhe drejtimin, në të cilin po ecën, dhe më e rëndësishmja, ata duan të dinë se çfarë mund të bëjë Kina për botën. Të gjitha këto mund të përmbliohen në një pyetje në dukje të thjeshtë: Si ta kuptojmë Kinën? Kjo është një pyetje shumë e gjerë për t’u përgjigjur vetëm me disa fjalë.

Historia e një kombi të madh ka patjetër kthesa dhe zigzage. Disa njerëz në vendet e tjera kanë paragjyqime ndaj Kinës, kryesisht për shkak të keqkuptimeve. Qëllimi i kësaj serie është të sqarojë pikërisht këto keqkuptime.

Libri “Kina në Fokus” është përgjigjja jonë ndaj pyetjeve të bëra nga ata që janë të interesuar për vendin tonë. Këta libra ofrojnë një përfytyrim të saktë mbi historinë dhe mënyrën e qeverisjes së Partisë Komuniste të Kinës, mbi suksesin e madh të Reformës dhe Hapjes, përpjekjet e vendit tonë në luftën kundër korrupsionit, rolin e saj në qeverisjen globale, mbi nismën “Një brez, Një Rrugë”, strategjinë e synuar për zbutjen e varfërisë, politikatat e mbrojtjes së mjedisit dhe aspekte të tjera të rrugës së zhvillimit të vendit. Ndër temat që lidhen me Kinën, këto janë ato që i shqetësojnë më tepër njerëzit në vendet e tjera. Informacioni që përmbajnë këta libra mund t’i ndihmojë lexuesit të kuptojnë më mirë Kinën.

Për të kuptuar më mirë Kinën nevojitet një vështrim historik. Qytetërimi kinez numëron mbi 5000 vjet dhe mund të krenohet me një trashëgimi të pasur kulturore. Urtësia dhe bindja si një vend i lashtë oriental kanë kaluar brez pas brezi. Mendimet e filozofëve të mëdhenj kinezë si Konfuci, Mencius dhe Laozi ende shkëlqejnë si fenerë, duke e udhëhequr brez pas

brezi popullin kinez. Ideja e vjetër e bashkëjetesës harmonike është gur themeli i konceptit të “komunitetit të së ardhmes së përbashkët për të gjithë njerëzimin”. “Supa bëhet e shijshme duke kombinuar përbërës të ndryshëm.” Kjo thënie e lashtë shpjegon një nga qëllimet e nismës “Një Brez, Një Rrugë”: të festojmë bukurinë e unitetit në diversitet. Kina ka qenë një mbështetëse e vendosur e kësaj filozofie të lashtë të qeverisjes. Nën udhëheqjen e PKK-së, Kina ka hyrë në një rrugën e zhvillimit me karakteristika kineze.

Për të kuptuar më mirë Kinën, nevojitet gjithashtu një vështrim mbi zhvillimin. Kina është ende një vend në zhvillim. Ashtu si edhe vendet e tjera, ajo përballet me doemos me pengesa dhe sfida të ndryshme në rrugën e saj të rritjes. Dyzet vjet më parë Kina nisi të zbatonte politikën e Reformës e të Hapjes. Sot Kina është ngritur në këmbë, është pasuruar dhe po bëhet e fuqishme. Ne jemi të vendosur të vijojmë më tej reformën për të siguruar një rritje të qëndrueshme. Kina që ka nxjerrë nga varfëria mbi 700 milion njerëz, i ka dhënë përparësi mbrojtjes së mjedisit duke zbatuar një zhvillim të qëndrueshëm. Populli kinez vlerëson mjedisin dhe përpiqet ta mbrojë atë për brezat e ardhshëm.

Për të kuptuar më mirë Kinën, ajo duhet parë nga pikëpamja

globale. Kina dëshiron të përqafojë botën.

Ëndrrat e popullit kinez nuk janë aq të ndryshme nga ëndrrat e popujve të tjerë. Kina është e angazhuar për ndërtimin e një komuniteti me të ardhme të përbashkët. Ajo do të ndjekë pa u lëkundur rrugën e zhvillimit paqësor dhe do të qëndrojë plotësisht e vendosur për ndërtimin e paqes në gjithë botën, do të kontribuojë në prosperitetin global dhe do të mbështesë rendin ndërkombëtar. Si vendi në zhvillim më i madh, Kina do të përfshihet në mënyrë aktive në qeverisjen globale dhe do të marrë rolin përkatës në zhvillimin global.

Për të kuptuar më mirë Kinën, duhen lënë mënjanë paragjykimet. Pikëpamjet në lidhje me Kinën dhe PKK-në ndryshojnë shumë në të gjithë botën. Disa madje e kanë marrë ngritjen e Kinës si një kërcënim për vendin e tyre. Kina, si edhe çdo vend tjetër, nuk është ë përsosur. Sidoqoftë, nën udhëheqjen e PKK-së, populli kinez ka hyrë në rrugën e zhvillimit socialist me karakteristika kineze dhe ka punuar shumë për të ndërtuar një vend të madh modern socialist si një vend i lulëzuar, i fortë, demokratik, i përparuar kulturalisht, harmonik dhe i bukur. Për më tepër, kinezët e paqedashës janë më se të gatshëm të ndajnë frytet e zhvillimit me pjesën tjetër të botës.

Ky vit shënon 70-vjetorin e themelimit të Republikës

Popullore të Kinës. Që nga dita e themelimit të vet, vendi në zhvillim më i madh i botës ka hyrë në rrugën e vet të pavarur drejt zhvillimit. Kina ka dalë me sukses nga varfëria e përhapur dhe është shndërruar në një vend të lulëzuar vetëm pas 70 vjetësh. Siç thotë një fjalë e urtë: “Faktet flasin më shumë se fjalët”. Pikërisht për faktet bëhet fjalë për këtë seri.

Pritet që kjo seri të shërbejë si një dritare për parë Kinën, duke u dhënë mundësi një numri të madh njerëzish të shikojnë se çfarë po ndodh në këtë vend.

Përmbajtja

Parathënie 1

Kapitulli 1 5

Një tranzicion i shkëlqyer për të prezantuar Reformën (1978-1984) 5

Fillimi: Plenumi i Tretë i Komitetit Qendror të 11-të të PKK-së 6

Emancipimi i mendjes dhe vendosja e rregullit nga kaosi 9

Përparësitë në zonat rurale: Fiksimi i kuotave të prodhimit
për familjet 16

Fillimi i reformës së ndërmarrjeve 23

Fillimi i Reformës dhe i Hapjes 34

Rivendosja dhe rindërtimi i sundimit të ligjit 39

Kapitulli 2

Fokusimi i reformave nga fshati në qytete (1984-1992) 45

Reforma e strukturës ekonomike me theks në qytete 46

Reforma Ekonomike Urbane: nga eksperimenti në zgjerim	48
Reforma e mëtejshme rurale në koordinim me reformën urbane	54
Reforma e ndërmarrjeve: Referencë qendrore	59
Lindja e sistemit të aksioneve dhe tregu i kapitalit	66
Reforma e çmimeve	69
Reforma fillestare e sistemit politik	73
Një model i hapjes me disa shtresa	79
Reforma e arsimit, kujdesit mjekësor dhe sistemeve të strehimit	86

Kapitulli 3

Themelimi i ekonomisë socialiste të tregut

(1992-2002)	93
Qëllimet e krijimit të ekonomisë socialiste të tregut	94
Reforma e NSH-ve në vitet 1990	98
Krijimi i një sistemi makrokontrolli financiar të orientuar nga tregu	109
Integrimi në botë	120
Qeverisja e vendit me sundimin e ligjit	129
Reforma e qeverisë: Efikasiteti, transparencja dhe sundimi i ligjit	132
Reforma për të siguruar përfitimet e përbashkëta për të gjithë	136
Reforma e ndërmarrjeve të kantoneve: Pikat kryesore të zonave rurale të Kinës në fillim të viteve 1990	142

Kapitulli 4

Përmirësimi i ekonomisë socialiste të tregut

(2002-2012)	147
Roli më i madh i tregut në shpërndarjen e burimeve	148
Prosperiteti i moderuar dhe koncept shkencor për zhvillimin	152
Reforma e mëtejshme e NSH-ve, duke u përqendruar në menaxhimin e pasurive në pronësi të shtetit	156
Zhvillimi i tregut të kapitalit	159
Ekonomia private bën përparim të ri	163
Reforma rurale po hyn në një fazë të re	168
Ndërtimi i një qeverie të orientuar nga shërbimi	171
Shkaku social si një referencë e rëndësishme për të ndërtuar një shoqëri harmonike	174

Kapitulli 5

Faza e re e reformës së përgjithshme në nivele

më të thella (2012-2017)	181
Strategjia gjithëpërfshirëse katërpikëshe	182
Reforma strukturore lidhur me ofertën	188
Reformat kryesore në financa dhe tatime	195
Zhvillim inovativ	199
Zhvillimi rajonal	201
Reforma e masave sociale për barazi dhe drejtësi	208
Reforma qeveritare për të modernizuar administratën	215

Një ekonomi e hapur	218
Konceptim i nivelit të lartë për përparimin ekologjik	223
Thellimi i reformës së sistemit kulturor	226
Reforma e sistemit gjyqësor dhe forcimi i sundimit të ligjit	230

Kapitulli 6

Të sigurojmë një fitore vendimtare të socializmit

kinez në epokën e re (2017-) 235

Kongresi i 19-të Kombëtar i PKK-së dhe Mendimi i shokut	
Xi Jinping mbi socializmin me karakteristika kineze për një epokë të re	236
Lufta për rritjen e cilësisë dhe ndërtimi i një ekonomie moderne	239
Thellimi i reformave administrative dhe gjyqësore	245
Rivitalizimi i fshatit	252
Hapja në të gjitha sferat	255
Përmirësimi i mirëqenies së njerëzve dhe përparimi ekologjik	261
40-vjetori i Reformës dhe i Hapjes	266

Postscriptum 268

Parathënie

Reforma dhe Hapja përcaktojnë Kinën bashkëkohore. Kjo është një zgjedhje kritike, nga e cila varet e ardhmja e vendit. Në fjalimin e tij programatik në konferencën vjetore të Forumit Boao për Azinë më 2018, Presidenti Kinez Xi Jinping theksoi: “Më 1978, me propozim të shokut Ten Hsiao Pin dhe me miratim nga Plenumi i Tretë i Komitetit Qendror të 11-të të PKK-së, Kina filloi kursin e saj historik të Reformës dhe Hapjes. Nga fshat në qytete, nga pistat eksperimentale deri në zbatim të gjerë, nga reforma ekonomike deri te reforma e përgjithshme, ne kemi shkruar një kapitull të lavdishëm të kombit dhe popullit tonë gjatë këtyre 40 vjetëve, duke luftuar të gjithë së bashku dhe duke përparuar megjithë vështirësitë e mëdha.

Synimi drejt hapjes e ka ndryshuar thellësisht Kinën. Gjatë një periudhe 40- vjeçare Kina ka shfrytëzuar me sukses mundësitë historike të krijuara nga globalizimi, duke mbështetur politikën themelore kombëtare të Hapjes. Ajo ka kryer një tranzicion të shkëlqyer nga një

ekonomi e mbyllur në hapjen e përgjithshme, duke kontribuar tej mase në rritjen globale.

Përmbledhja e përvojës së Kinës tregon se ajo ika rritur ndjeshëm tregjet dhe ekonominë e saj përmes reformave. Në vitet 1978-2018, PBB-ja e Kinës u rrit me 35.7 fish, duke regjistruar një mesatare vjetore prej 9.4%, shumë më e lartë se ritmet e rritjes së ekonomive të tjera të mëdha gjatë së njëjtës periudhë. Pjesa e PBB-së së saj në ekonominë globale u rrit nga 1.8% në 15%, duke e bërë atë ekonominë e dytë me rritje më të shpejtë.

Synimi i Kinës drejt hapjes ka pasur një ndikim të thellë në botë. Duke u nisur nga zona të veçanta ekonomike, Kina ka zgjeruar një rrjet shumështrësor të qyteteve të hapura nga bregdeti deri në brendësi.

Në kapërcyellin e shekullit XXI, Kina u bë anëtare e OBT-së, duke e organizuar ekonominë e saj të brendshme sipas rregullave të tregtisë botërore. Që nga Kongresi i 18-të Kombëtar i PKK-së në vitin 2012, Kina ka propozuar nismën “Një Brez, Një Rrugë”; krijimin e zonave dhe porteve të tregtisë së lirë, si pjesë e përpjekjes për të ngritur një ekonomi të hapur; dhe pjesëmarrjen në qeverisjen globale ekonomike përmes Forumit Ekonomik Botëror, Samitit të G20 dhe Organizatës së Bashkëpunimit të Shangait. Kina po ecën më shpejt për të ndryshuar rolin e saj nga një pjesëmarrës dhe ndjekës në një promovues dhe lehtësues të globalizimit. Sapo Presidenti Xi Jinping bëri propozimin për ndërtimin e një komuniteti të së ardhmes së përbashkët për njerëzimin më 2013, ai është përshëndetur dhe mirëpritur me ngrohtësi nga gjithnjë e më shumë vende dhe njerëz. Si një vend i madh, Kina po kontribuon me mençurinë dhe zgjidhjet kineze për të promovuar paqen dhe zhvillimin botëror për një të ardhme më të ndritshme të njerëzimit. Mund të thuhet se Reforma dhe Hapja jo vetëm që

kanë ndryshuar Kinën, por ka ndikuar edhe mbi botën.

Reforma dhe Hapja janë një çelës i rëndësishëm për të kuptuar Kinën bashkëkohore. Kinës iu deshën vetëm disa dhjetëvjeçarë për t'u bërë prodhuesi më i madh në botë, tregtari më i madh i mallrave, vendi i dytë më i madh për nga vëllimi i investimeve, investitori i tretë më i madh dhe investitori më i madh midis vendeve në zhvillim. Pse themi që Reforma dhe Hapja janë çelësi për të marrë vendime për të ardhmen e Kinës bashkëkohore? Si i ka përjetuar Kina 40 vjetët e Reformës e të Hapjes? Çfarë ka bërë dhe cila është përvoja e saj? Duke u hedhur një vështrim katër dekadave të fundit, ky libër tregon historitë e Reformës dhe të Hapjes të Kinës në rend kronologjik për t'i ndihmuar lexuesit në të gjithë botën të kuptojnë nismën e madhe.

Një përmbledhje e përvojës së kaluar ndihmon për të vazhduar më mirë rrugëtimin. Në mbledhjen përkujtimore kushtuar 40- vjetorit të Reformës e të Hapjes, Presidenti Xi Jinping theksoi: "Përvoja e vlefshme e grumbulluar gjatë 40 viteve të Reformës e të Hapjes është një pasuri shpirtërore e Partisë dhe e popullit, pasi ajo udhëheq praktikën tonë të mbrojtjes dhe të zhvillimit e socializmit kinez në epokën e re. Ne duhet ta përvetësojmë atë dhe të vazhdojmë ta pasurojmë dhe ta zhvillojmë në praktikë.

Në këto momente ne ndodhemi në një etapë të re historike të Reformës. Nuk është më e lehtë se 40 vjet më parë duke marrë parasysh kompleksitetin, ndjeshmërinë dhe vështirësinë e detyrave. Për ta çuar reformën deri në fund, ne duhet të jemi të guximshëm dhe të vendosur për të bërë përparime, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm në perspektivën afatgjatë.

Në Plenumin e Tretë të Komitetit Qendror të 11-të të PKK-së në dhjetor 1978, Partia dha udhëzimin për të “emancipuar mendjen dhe për ta kërkuar të vërtetën nga faktet”, dhe vendosi të zhvendosë theksin e punës dhe fokusin e Partisë dhe të kombit te zhvillimi ekonomik dhe të iniciojë Reformën dhe Hapjen. Rezoluta për disa çështje në historinë e Partisë sonë që nga themelimi i Republikës së Popullit të Kinës, e miratuar në Plenumin e Gjashtë të Komitetit Qendror të 11-të të PKK-së, arriti në përfundimin se Revolucioni Kulturor ishte i gabuar, duke vendosur kështu rendin në vend të kaosit.

Një tranzicion i shkëlqyer për të prezantuar Reformën (1978-1984)

Fillimi: Plenumi i Tretë i Komitetit Qendror të 11-të të PKK-së

Hyrje: konferenca qendrore e punës e Komitetit Qendror të PKK-së më 1978

Plenumi i Tretë i Komitetit Qendror të 11-të të PKK-së u mbajt në një moment kritik të historisë kineze. Më 10 maj 1978, *Lëvizja Teoria*, një botim i brendshëm i Shkollës së Komitetit Qendror të PKK-së, botoi “Praktika është kriteri i vetëm për testimin e së vërtetës”, një artikull i shqyrtuar nga Hu Yaobang, zëvendës-president i shkollës. Artikulli nxiti një diskutim mbarëkombëtar mbi kriteret e verifikimit të së vërtetës, që shërbeu si bazë teorike për seancën plenare.

Nga 10 nëntori deri më 15 dhjetor 1978, në Hotelin Jingxi në Pekin u mbajt konferenca qendrore e punës e Komitetit Qendror

të PKK-së. Në takim shoku Ten Hsiao Pin mbajti një fjalim të rëndësishëm me titullin “Emanciponi mendjen, Kërkoni të vërtetën nga faktet, dhe Bashkohuni në kërkim të së ardhmes.”, duke theksuar se udhëheqja qendrore kishte propozuar që theksi i punës Partisë të zhvendosej te përqendrimi i në realizimin e “katër modernizimeve”. Ai theksoi se e gjithë Partia duhet të çlirojë mendjen e saj, të vrasë mendjen shumë, të kërkojë të vërtetën nga faktet dhe të bashkohet si një trup në kërkim të së ardhmes. Fjalimi i tij ngjalli jehonë të madhe dhe shërbeu si deklaratë për emancipimin e mendjes në epokën e re. Ajo përgatiti të gjithë Partinë për trajtimin e saktë të çështjeve historike dhe nisje e Reformës dhe Hapjes në seancën plenare që pasoi.

Një tranzicion i shkëlqyer: Plenumi i Tretë i Komitetit Qendror të 11-të të PKK-së

Nën udhëheqjen e shokut Ten Hsiao Pin dhe me mbështetjen e revolucionarëve të tjerë veteranë, dhe mbi bazën e konferencës qendrore të punës, Plenumi i Tretë i Komitetit Qendror të 11-të të PKK-së u mbajt në Pekin më 18-22 dhjetor 1978.

Plenumi shqyrtoi gabimet e majta të Revolucionit Kulturor dhe kritikoi politikën e “dy palëve”. Ai theksoi se Mendimi i shokut Mao Ce Dun duhet të konsiderohet gjithëpërfshirës dhe i saktë. Veç kësaj, diskutimi i madh për kriteret e verifikimit të së vërtetës u cilësuan me vlerë të madhe dhe u përcaktua udhëzimi “të emanciponi mendjen, të kërkonit të vërtetën nga faktet dhe të bashkohen të gjithësi një trup në kërkim të së ardhmes”. Ai mori

një vendim historik në favor të Reformës dhe Hapjes dhe për një vëmendje më të madhe ndaj modernizimit socialist.



Besimi i njerëzve, kërkimi i së vërtetës nga faktet, promovimi i demokracisë

Në Plenumin e Tretë të Komitetit Qendror të 10-të të PKK-së në korrik 1977, shoku Ten Hsiao Pin theksoi: “Ne duhet t’u besojmë plotësisht njerëzve, kërkoni të vërtetën nga faktet, promovoni demokracinë, rivendosni teoritë e ndërtimit të Partisë së shokut Mao Ce Dun, dhe vazhdoni traditat e mira të sjelljes së partishme.

Emancipimi i mendjes dhe vendosja e rregullit nga kaosi

Një debat i madh për kriteret e verifikimit të së vërtetës

Më 7 shkurt 1977 në një artikull redaksional me titull “Njihni dokumentet dhe kuptoni parimet”, botuar në të përditshmen popullore “*Flamuri i Kuq*”, dhe *Gazeta UCA*, u hodh ideja e “dy palëve” - “Ne do të mbështesim me vendosmëri çdo vendim politik të marrë nga Kryetari Mao dhe çdo udhëzim të dhënë nga Kryetari Mao.”

Më 11 maj 1978, gazeta *E përditshmja Guangming* botoi artikullin me titull “Praktika është kriteri i vetëm për verifikimin e së vërtetës”. Artikulli shpjegoi se praktika sociale është kriteri i vetëm për verifikimin e së vërtetës, se lidhja e teorisë me praktikën është një nga parimet më themelore të marksizmit dhe se çdo teori duhet të verifikohet nga praktika. Kjo ishte një kritikë ndaj parimit të “dy palëve”. Artikulli ngjalli një reagim të



**“Praktika është kriteri i vetëm për
verifikimin e së vërtetës”**

Unë mendoj se parimi i “dy palëve” është shembull tipik i idealizmit dhe metafizikës. Thelbi i tij qëndron në heqjen dorë nga praktika si kriter, dhe në mohimin e teorive të verifikimit e udhëzimeve, politikave dhe vendimeve në praktikë.

- H u F u m i n g, autori kryesor i Rezoluta për disa çështje të historisë së Partisë sonë që nga themelimi i RP të Kinës

fuqishëm dhe një debat të nxehtë në të gjithë vendin mbi kriteret e verifikimit të së vërtetës.

Debati i madh sqaroi gabimet e së majtës, duke paralajmëruar përpjekjet që do të pasonin për të vendosur rendin nga kaosi në të gjitha frontet. Ajo bëri përgatitjen e nevojshme ideologjike për vendimin e Reformës dhe Hapjes të marrë në Plenumin e Tretë të Komitetit të 11-të Qendror të PKK-së.

**Rezoluta për disa çështje në historinë e Partisë sonë që
nga themelimi i Republikës Popullore të Kinës**

Më 12 tetor 1980 Zyra e Përgjithshme e Komitetit Qendror të PKK-së publikoi një njoftim për të organizuar një seancë

diskutimi ku do të merrnin pjesë rreth 4,000 vetë. Më 27-29 qershor 1981 në Pekin u mbajt Plenumi i gjashtë i Komitetit Qendror të 11-të të PKK-së. Në Plenum u rishikua dhe u miratua Rezoluta për disa çështje të historisë së Partisë sonë që nga themelimi i Republikës Popullore të Kinës..

Rezoluta vuri në dukje se Mendimi i shokut Mao Ce Dun është një përmbledhje e parimeve të sakta teorike dhe përvojës së revolucionit kinez, të cilat ishin provuar në praktikë. Ai u konsiderua si kristalizimi i mençurisë kolektive të komunistëve kinezë. Kina duhet të mbështesë Mendimin e shokut Mao Ce Dun, ta pasurojë dhe ta zhvillojë atë me parime dhe përfundime të reja në dritën e realiteteve të reja.

Miratimi i Rezolutës tregoi se PKK kishte përmbushur misionin e nxjerrjes së rendit nga kaosi. Kjo ka qenë një ngjarje me rëndësi epokale në unifikimin e mendimit të Partisë, ushtrisë dhe popullit, në mobilizimin e të gjithë faktorëve pozitivë dhe forcën galvanizuese për të punuar drejt qëllimeve të reja, dhe në thirrjen e tërë kombit që të përpiqet për modernizimin. Ajo përmbodhi mësimet e nxjerra, zgjidhi çështjet e pazgjidhura dhe hodhi një bazë të shëndoshë politike për zhvillimin e Partisë dhe shtetit në epokën e Reformës dhe Hapjes.

Rivendosja e provimit të pranimit në kolegji

Në vitet 1966-1971, ndërpreu plotësisht regjistrimet institucionet e arsimit të lartë të Kinës.. Në vitet 1972-1976 universitetet rekrutuan studentë nga punëtorë, fermerë dhe ushtarë, në



**“Mos bëni ndryshime para dhe mbrapa kur
ato vendosen”**

Në takimin për shkencën dhe arsimin, shoku Ten Hsiao Pin paraqiti pikëpamjet e tij: vitin e ardhshëm ne do të vendosim një sistem të ri arsimor. Këtë vit duhet të bëhen përgatitje për sistemin shkollor, materialet mësimore, mësuesit, burimin e studentëve, regjistrimin, provimi dhe vlerësimin. Gjithçka duhet të bëhet e qartë. Mos bëni ndryshime para dhe mbrapa kur ato vendosen.

bazë të vetaplikimit, rekomandimit publik, miratimit nga autoritetet dhe rekomandimeve shkollore.. Kjo mënyrë e paarsyeshme i bëri njerëzit të besojnë se arsimit ishte i padobishëm, dhe cilësia e arsimit u ul seriozisht. Kishte një mungesë të theksuar të personelit profesional shumë të nevojshëm për ndërtimin kombëtar.

Më 4-8 gusht 1977 shoku Ten Hsiao Pin kryesoi një takim mbi shkencën dhe arsimin në Pallatin e Madh të Popullit. Në takim morën pjesë rreth 30 shkencëtarë dhe arsimtarë të njohur, dhe shoku Ten Hsiao Pin një fjalim të rëndësishëm, i cili më vonë u bë i njohur si “Fjalimi i 8 gushtit”. Një vendim i miratuar në atë mbledhje çoi drejtpërdrejt në rifillimin e provimit të pranimit në kolegji, duke ndryshuar fatin e dhjetëra miliona njerëzve.

Pranvera e shkencës: konferenca kombëtare e shkencës

Më 18-31 Mars 1978, në Pekin u mbajt një konferencë kombëtare për shkencën. Në ceremoninë e hapjes shoku Ten Hsiao Pin mbajti një fjalim të rëndësishëm, duke theksuar se çelësi i modernizimit ishte modernizimi i shkencës dhe i teknologjisë, se Kina duhet të kultivonte një kontingjent shkencëtarësh dhe teknikësh të klasit botëror, dhe se intelektualët ishin një pjesë e klasës punëtore. Ai pohoi: “Shkenca dhe teknika përbëjnë forcën kryesore prodhuese.”

Ndonëse me temë mbi shkencën dhe teknologjinë, konferenca kishte rëndësi të përgjithshme. Ajo përcaktoi parimet udhëheqëse mbi zhvillimin shkencor dhe teknologjik dhe rivendosi respektin



Përqaftimi i pranverës së shkencës

Para se të mbyllej konferenca kombëtare e shkencës, në vend u lexua një fjalim i shkruar nga Guo Moruo, presidenti 86-vjeçar i Akademisë së Shkencave Kineze. I titulluar “Përqaftimi i pranverës së shkencës”, ai thotë: “Pranvera më e shkëlqyer e shkencës në historinë e kombit tonë është këtu”; “Kjo është pranvera e shkencës! Le t’i hapim krahët tanë të gjerë dhe ta përqafojmë.”

për shkencën dhe teknologjinë në të gjithë shoqërinë. Ajo shënoi një fillim të ri të nxitjes së modernizimit.

Katër diskutime mbi shpërndarjen sipas punës

Diskutimi mbi shpërndarjen sipas punës nuk është vetëm çështje teorike, por ka të bëjë edhe me interesat jetike të njerëzve dhe nxitjen e modernizimit.

Në prill, qershor dhe tetor 1977, në Pekin mbi këtë çështje u zhvilluan tri diskutime çdo herë në një shkallë edhe më të madhe.

Në këto takime më së shumti u kritikua Bandat e të Katërve dhe udhëzimet majtiste në të kaluarën, për të rivendosur rregullin në frontin teorik.

Në maj të vitit 1978, nën udhëheqjen e shokut Ten Hsiao Pin, Zyra e kërkimit politik të Këshillit të Shtetit shkroi artikullin me titull “Zbatimi i parimit socialist të shpërndarjes sipas punës”, i cili u botua në të *“Përditshmen Popullore”* më 5 maj, duke rikthyer kështu “reputacionin” e parimit. Mbështetja e fortë e shokut Ten Hsiao Pin ndaj parimit vendosi një bazë të qëndrueshme për zhvendosjen e theksit të punës së Partisë në zhvillimin ekonomik.

Në tetor 1978, përpara takimit qendror të punës, në Pekin u mbajt një diskutim i katërt në një shkallë edhe më të gjerë për këtë çështje. Në përgjithësi, u arrit një përparim i madh në rivendosjen e parimit të shpërndarjes sipas punës gjatë kësaj periudhe.



“Lëri diŝa njerëz të paŝurohen së pari”

Mendimi i gabuar për ŝocializmin dhe barazinë në ŝpërndarje dëshmoi ŝe ishte një pengesë kryesore për reformën. Gjatë inspektimit të tij në Tianjin më 20 ŝtator 1978, ŝoku Ten Hŝiao Pin e bëri të qartë ŝe diŝa njerëz duhet të paŝurohen së pari. Në zonat me kushte të përŝtatŝme, njerëzit inkurajoheshin të fitonin më ŝumë përmes punës dhe biznesit të ndershëm.

Përparësitë në zonat rurale: Fiksimi i kuotave të prodhimit për familjet

Fshati Xiaogang, pionier

Një thatësi e fortë goditi në vjeshtën e vitit 1978 Provincën Anhui. Komiteti Provincial i PKK-së i Anhuit vendosi të lejojë fermerët të punojnë fushat shtesë dhe të mbanin për vete gjithçka që mund të korrnin, dhe fermerët nuk kishte pse ta dorëzonin drithin. Kjo i motivoi shumë fermerët dhe çoi në krijimin e një brigade prodhimi në Xiaogang, Provinca Fengyang për të rregulluar kuotat për secilën prej familjeve të saj. Është futur sistemi i përgjegjësisë së kontratave shtëpiake, duke thyer sistemin e vjetër të ekonomisë së planifikuar në zonat rurale me reforma të reja.

Me përcaktimin e kuotave të prodhimit për familjet, prodhimi shtëpiak u nda nga prodhimi kolektiv. Meqenëse fitimet e fermerëve lidheshin me vëllimin e prodhimit, ata u bënë më të motivuar dhe u rrit efikasiteti.



Të korra të pabesueshme

Në tetor 1979, fshati Xiaogang pati të korra të pabesueshme. Prodhimi i përgjithshëm i grurit ishte 66 tonë, që ishte i barabartë me prodhimin e përgjithshëm nga viti 1966 deri në 1970.

Legalizimi i fiksimit të kuotës shtëpiake

Plenumi i Tretë i Komitetit Qendror të 11-të të PKK-së miratoi Vendimin e Komitetit Qendror të PKK-së për disa çështje për përshejtimin e prodhimit bujqësor (projekti) dhe Rregulloren e Komunave të Popullore Rurale (drafti për gjykim), për t'u diskutuar dhe hedhur në gjyq në krahina, rajone autonome dhe bashki drejtpërdrejt nën qeverinë qendrore. Politikat e reja nuk lejuan rregullimin e kuotave të prodhimit për familjet ose ndarjen e tokës bujqësore, por konfirmuan që fermerët mund të punojnë në kuotat e përcaktuara për grupet e tyre dhe të marrin pagesa sipas rezultatit. Më 20 maj 1979, e Përditshmja e Popullit botoi një artikull të titulluar “Një masë e fortë për të motivuar fermerët”, e cila afirmoi praktikën e përmendur. Ky ishte fillimi i sistemit të përgjegjësisë së kontratës shtëpiake.

Në fund të vitit 1979, në një seminar të organizuar nga

Shoqata Kineze e Ekonomisë Bujqësore, përfaqësues nga Anhui ndanë përvojën e tyre të rregullimit të kuotave të prodhimeve për familjet në qarqet Feixi dhe Fengyang. Qarku Fengyang, në veçanti, tërhoqi vëmendjen e gjerë me reformat e tij: fermerët mund të mbanin gjithçka që mbetet pas dorëzimit të aksioneve të duhura të grurit në shtet dhe kolektiv.

Më 14-22 Shtator 1980, Komiteti Qendror i PKK-së mbajti një seminar me sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të provincave, rajoneve autonome dhe bashkive që vareshin direkt nën qeverinë qendrore. Shumë të pranishëm nuk shprehën mbështetje të qartë për praktikën e fiksimit të kuotave, dhe disa shprehën një kundërshtim të fortë.

Nënkryeministri Wan Li i Këshillit të Shtetit ngarkoi Du Runsheng, zv / drejtor i Komisionit Kombëtar të Bujqësisë, të hartonte një dokument mbi këtë çështje. Du shkruajti me zgjuarsi dhe hartoi Njoftimin e Komitetit Qendror të PKK-së për një varg çështjesh mbi forcimin dhe përmirësimin e e mëtejshëm të sistemit të prodhimit bujqësor.

Dokumenti theksoi se ekonomia kolektive ishte themeli i palëkundshëm për modernizimin e bujqësisë kineze, por praktika e vjetër e komunave popullore duhet të reformohet. Nëse fermerët dëshironin që kuotat e prodhimit të përcaktoheshin për secilën familje, komunat duhet ta mbështesin një kërkesë të tillë.

Dokumenti theu prangat e “ringjalljes së kapitalizmit” që kishin penguar përparimin për vite me radhë dhe lajti një rol aktiv në mbështetjen dhe mbrojtjen e fermerëve në të gjithë



Wan Li për fiksimin e kuotës shtëpiake

Wan Li tha me shaka: “Foshnja ka lindur. Është një fëmijë i bukur, fqinjët e kanë parë të gjithë dhe e pëlqejnë shumë. Por më pas ata ndryshuan mendim. Pse? Pse e kritikojnë dhe e akuzojnë si kapitalist? Sipas mendimit tim, ne duhet të respektojmë idetë e njerëzve. Kështu që unë do ta “regjistroj” atë si një formë të sistemit të përgjegjësisë së kontratës. “

– Wang Yuzhao, ish guvernator i Provincës Anhui

vendin që ushtronin sistemin e përgjegjësisë së kontratave shtëpiake.

Vendosja e sistemit të përgjegjësisë së kontratës shtëpiake

Më 1980 praktika e fiksimit të kuotave përfshiu të gjithë vendin. Ndërsa dokumenti Nr. 75 ishte thyer në realitet, udhëheqja qendrore mendoi të hartojë një dokument i ri për çështjet rurale.

Në fund të vitit 1981, procesverbali i konferencës kombëtare të punës rurale u botua si dokumenti numër 1 i vitit 1982. Kjo ishte hera e parë që PKK lëshoi një dokument qendror nr.1 për

punën rurale. Dokumenti hoqi pengesën e fundit për fiksimin e kuotave shtëpiake, konfirmoi drejtimin socialist të praktikës dhe reformat rurale dhe vendosi në thelb sistemin e përgjegjësisë së kontratave shtëpiake. Që atëherë, kjo praktikë u bë një prirje e pandalshme në të gjithë vendin.

Më 2 janar 1983, disa çështje mbi politikat aktuale ekonomike rurale, doli dokumenti i dytë qendror numër. Ai bëri një vlerësim shkencor trendit të reformës rurale: Bumi i prodhimit të mallrave ishte tipari themelor i një ekonomie rurale optimiste. Kjo shënoi fillimin e kalimit historik nga vetë-mjaftueshmëria në prodhimin profesional dhe të socializuar në fshat të Kinës.

Politika i zgjidhi fermerët nga rregullat e ngurtë dhe i dha jetë ekonomisë rurale. Ajo gjithashtu krijoi mjedisin për zhvillimin e prodhimit të mallrave në zonat rurale.

Nga komunat në qytete: fundi i komunave popullore

Në shtator 1979 Komiteti i Partisë së Distriktit Guanghan në Provincën Sichuan zgjodhi Komunën Popullore Xiangyang për të filluar një gjykim mbi ndarjen e qeverisë dhe komunave. Në shkallë vendi, pasi praktika e fiksimit të kuotave shtëpiake u bë një trend pas vitit 1982, komunat popullore ekzistonin vetëm në afate nominale.

Më 12 tetor 1983, Komiteti Qendror i PKK-së dhe Këshilli i Shtetit nxorën njoftimin për ndarjen e Qeverisë nga komunat dhe Vendoqjen e Qeverive të kantoneve, duke kërkuar krijimin e

qeverive vendore në nivel komunash për të ushtruar udhëheqjen administrative të organizatave ekonomike në nivele të ndryshme. Nën nivelin e kantonit duhej të ishin komitetet fshatare për të ushtruar funksionet administrative të ekipeve të mëparshme të prodhimit. Në fund të vitit 1984, reforma e komunave popullore praktikisht kishte përfunduar, dhe komunat u bënë diçka e së kaluarës.

Në tetor 1992, Kushtetuta e Republikës Popullore të Kinës u ndryshua në Plenumin e parë të Komitetit të Përhershëm të Kongresit të Tetë Kombëtar të Popullit. Në përmbajtje e Kushtetutës çështja e komunave popullore u hoq dhe sistemi i



Komuna e parë popullore e reformuar në Kinë

Në mesditën e 18 qershorit 1980, pllaka që mbante emrin “Komiteti i Menaxhimit të Komunës së Xiangyang të Komunës së Qarkut Guanghan” u hoq dhe u zëvendësua nga një pllakë e re e titulluar “Qeveria e Popullit e Qarkut Xiangyang të Qarkut Guanghan”. Ishte komuna popullore e parë e reformuar në Kinë.

përgjegjësishë për kontratën shtëpiake u bë një sistem themelor dhe afatgjatë i menaxhimit në zonat rurale.

Ngrtija e ndërmarrjeve qytetare

Më 1 mars 1984, Komiteti Qendror i PKK-së dhe Këshilli i Shtetit paraqitën Raportin mbi Ndërmarrjet në Zhvillim të Komunave dhe Ekipet e Prodhimit, një dokument i përpiluar nga Ministria e Bujqësisë, Blegtorisë dhe Peshkimit. Kjo u pasua nga një njoftim, i cili lejoi që këto ndërmarrje të quheshin “ndërmarrje qyteti”, duke u dhënë atyre një natyrë të re, të ndryshme nga versioni i tyre i mëparshëm. Kjo çoi në rritjen e ndërmarrjeve të qyteteve me një shpejtësi të paparë.



Rritja e papritur e ndërmarrjeve qytetare

Kur fliste për ndërmarrjet e qyteteve të Kinës, shoku Ten Hsiao Pin tha se ato ishin përfitimi më i madh që askush nuk e kishte pritur. Ndërmarrjet qytetare ishin vërtet një arritje e rëndësishme e reformave rurale të Kinës.

Fillimi i reformës së ndërmarrjeve

NSH “Zgjerimi i fuqisë”: nga eksperimenti në zbatimin e plotë

Në tetor 1978, me miratimin e Këshillit të Shtetit, Komiteti Provincial i PKK-së së Sichuan-it dhe qeveria provinciale zgjodhën gjashtë ndërmarrje industriale në pronësi shtetërore, duke përfshirë uzinën e pajisjeve të makinave Ningjiang, kombinatin metalurgjik dhe kompaninë e hekurit e të çelikut Chongqing, ndërmarrjen e tubave të çelikut Chengdu, uzinën kimike në Sichuan, etj. fabrikën e plehrave azotike të Qarkut Xindu dhe fabrikën e prodhimit të mëndafshit në Nanchong, fillimin e projektit pilot të “zgjerimit të fuqisë vendimmarrëse të ndërmarrjeve”.

Përmbajtja kryesore e reformës pilot përfshinte: kontrollimin dhe përcaktimin e objektivit të fitimit të secilës ndërmarrje; përcaktimin e qëllimit të rritjes së prodhimit dhe të ardhurave; lejimin që ndërmarrjet të mbajnë një sasi të vogël të fitimit si një

fond zgjerimi dhe të japin shpërblime të vogla për punonjësit e tyre pas përbushjes së planit të fundvitit. Në tremujorin e katërt të të njëjtit vit, ndërmarrjet pilot tashmë e kishin përbushur planin me një rritje të konsiderueshme të fitimit.

Më 31 janar 1979, Komiteti Provincial i PKK-së i Sichuan-it nxori përfundimet mbi zgjerimin e fuqisë vendimmarrëse të ndërmarrjeve dhe përshpejtimin e prodhimit dhe ndërtimit, duke rritur numrin e ndërmarrjeve pilot industriale nga gjashtë në 100, dhe gjithashtu vendosi të nisë një projekt pilot të zgjerimit të fuqisë vendimmarrëse të ndërmarrjeve në operim dhe menaxhim në 40 ndërmarrje tregtare shtetërore. Ky ishte fillimi i reformave të NSH-ve dhe reformës së ekonomisë urbane.

Në vitin 1979, Li Xiannian i kërkoi Komisionit Shtetëror Ekonomik dhe të Tregtisë të zgjeroheshin kompetencat e ndërmarrjeve; komisioni doli me 10 rregullore mbi këtë çështje, të cilat u konfirmuan në një takim qendror pune në prill. Në maj, gjashtë ministri dhe komisione, përfshirë Komisionin Shtetëror Ekonomik dhe Tregtinë dhe Ministrinë e Financave, lëshuan një njoftim për të konfirmuar tetë ndërmarrjet që ishin përfshirë në programet pilot. Ato përfshinin Kompaninë Kapitale të Hekurit dhe Kompaninë e Çelikut, Uzina e Biçikletave në Tianjin, Uzina e Motorëve Diesel të Shangait dhe pesë ndërmarrje të tjera.

Më 2 shtator 1980, Këshilli i Shtetit miratoi dhe shpërndau Raportin e Komisionit Shtetëror Ekonomik dhe të Tregtisë për eksperimentet për zgjerimin e kompetencave vendimmarrëse të ndërmarrjeve dhe sugjerimeve për punën e ardhshme, duke miratuar